

Aneksi A**SHPALLJA E VENDEVE TË LIRA TË PUNËS**

Tabela .1

Nr.	Pozicioni i punës	Struktura e interesuar/ Forca	Vendi ku ndodhet	Lloji i kontratës së punës	Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve		Afati i aplikimit	
					Me dosje	Intervista	Fillimi	Mbarimi
1	Inspektor Krimesh	Reparti Ushtarak Nr. 6620 Policia Ushtarake	Vlorë	Pa afat	Po	Po	21.01.2026	27.01.2026

Formulari nr. 1

1.Pozicioni i punës: Inspektor Krimesh, në Seksionin e Policisë Ushtarake, Vlorë.
2. Kodi i pozicionit: N/A
3. Reparti/Institucioni: Policia Ushtarake, Reparti Ushtarak Nr.6620, në SHPFA.
4. Vendi: Vlorë
5. Paga: VKM nr.325, datë 31.05.2023, i ndryshuar.
6. Lloji i kontratës së punës: Pa afat
7. Data e fillimit të aplikimit: 21.01.2026
8. Data e mbylljes së aplikimit: 27.01.2026
9. Mënyra e aplikimit: Për të aplikuar kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit, të cilin do ta gjejnë në faqen e internetit të Ministrisë së Mbrojtjes, në adresën www.mod.gov.al . Formulari pasi plotësohet, së bashku me dokumentacionin përkatës,do të dërgohet në: <i>Drejtorinë e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve</i> <i>Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës</i> <i>Tiranë</i>

10. Dokumentet e aplikimit:

Aplikantët duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- kërkesën;
- formularin e aplikimit;
- fotokopje të kartës së identitetit;
- diplomën e shkollës së lartë të noterizuar sëbashku me listë notash;
- fotokopje të patentës nëse ka;
- dëshmi profesioni nëse ka;
- certifikatë ose dëshmi të gjuhëve të huaja
- raport mjekësor;
- fotografi me përmasa 4x6, 2 copë dhe 9x12 2 copë;
- dëshmi penaliteti;
- vërtetim nga gjykata;
- vërtetim nga prokuroria;
- librezë pune;
- jetëshkrimin (CV)
- Letër motivimi
- formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në faqen e internetit të MM-së në adresën elektronike www.mod.gov.al. (linku: *Baza ligjore/Akte ligjore/ Integriteti i personave që ushtrojnë funksione publike/formulari i vetëdeklarimit*)

11. Kërkesat e përgjithshme të pozicionit të punës:

- a) të ketë shtetësinë shqiptare;
- b) të jetë jo më pak se 18 vjeç;
- c) të gëzojë zotësi të plotë për të vepruar;
- d) të plotësojë kërkesat për llojin dhe nivelin arsimor, si dhe të zotërojë aftësitë profesionale të domosdoshme, për vendin përkatës të punës, sipas kriterëve të miratuara;
- ç) të jetë i aftë për punë nga ana shëndetësore;
- e) të mos jetë i/e dënuar me burg me vendim gjykatë të formës së prerë për kryerje të një krimi;
- dh) të mos jetë marrë masa disiplinore me largim nga puna, brenda 1 viti nga data e aplikimit.

12. Kërkesat specifike të pozicionit të punës:

- | | |
|---------------------------------------|--|
| a. Grada/Titulli: | Inspektor Krimesh. |
| b. Arsimi: | Të ketë përfunduar arsimin e lartë “Master Profesional” në “Shkencat Shoqërore/Sociale”. |
| c. Kualifikimi: | Kualifikimet në fushën profesionale. |
| d. Trajnimi: | Trajnime në fushën profesionale. |
| e. Eksperienca në Punë: | Jo më pak se 2 (dy) vite eksperiencë në fushën profesionale. |
| f. Gjuha e huaj: | Të ketë njohuri të mira të gjuhës Angleze. |
| g. Kërkesa të tjera specifike: | Njohuri të mira në Platformat MS Office “Word”, “Excel”, “Power Point” |

h. Niveli i certifikatës së sigurisë: sipas VKM nr. 731, datë 27.11.2024 “Për miratimin e rregulores për sigurinë e personelit”.

Përshkrimi i punës: Kontribuon për hetimin/ parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme si dhe dëmtimin e pronës ushtarake në zonën e përgjegjësisë si dhe informon Komandantin e Policisë Ushtarake për realizimin e detyrave.

Detyrat kryesore:

- Të njohë dhe ushtrojë kompetencat e oficerit të Shërbimit të Policisë Gjyqësore, me marrje në dijeni për vepra kriminale që janë kryer apo përgatiten të kryhen në FA.
- Të kryejë punën operative-gjurmuese në njësitë dhe repartet ushtarake që mbulon, sipas zonës së përgjegjësisë, për zbulimin, parandalimin e ngjarjeve të jashtëzakonshme, ndjekjen e veprimtarisë kriminale dhe dëmtimit të pronës ushtarake, në zonën e përgjegjësisë.
- Mbi bazën e situatës kriminale të shfaqur në njësite dhe repartet ushtarake që mbulon dhe detyrat e dhëna nga eprori, të programoj, miratoj dhe zbatoj planin e punës mujor.
- Të zbatojë forma dhe metodat sekrete të investigimit kriminal të njohura me akte ligjore e nënligjore, të njohë në çdo kokë situatën operative kriminale në njësitë dhe repartet ushtarake që mbulon.
- Përgjigjet bashkë me agjentin që ka në vartësi, për zbulimin e autorëve të veprave kriminale të ndodhura në njësite dhe repartet ushtarake në zonën dhe repartet që mbulon.
- Bashkëpunon me specialistët e organeve të tjera homologe të investigimit brenda dhe jashtë radhëve të FA që veprojnë në zonën e përgjegjësisë së tij, për zbulimin, parandalimin e ndjekjen e veprimtarisë kriminale.
- Grumbullon, vlerëson e përpunon, informacionin për veprimtari kriminale dhe ja paraqet eprorit të tij menjëherë ose në mënyrë periodike sipas rëndësisë.
- Organizon punën në bashkëpunim me strukturat e tjera homologe për sigurimin e Personaliteteve të Larta Shtetërore dhe Ushtarake gjatë vizitave në repartet ushtarake që mbulon.
- Informon komandantëe e njësiteve e reparteve që mbulon për gjëndjen e kriminalitetit dhe sygjeron masat që duhet të marrin për parandalimin e tij, me përjashtim të rasteve kur gjykohet se kjo dëmton hetimin.
- Vepron me inisiativë për arrestimin apo ndalimin në flagrancë të ushtarakëve që kryejnë haptazi vepra kriminale sipas ligjeve në fuqi.

13. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një **komision vlerësimi** i përbërë nga 3 (tre) veta. Procedura e përzgjedhjes së kandidatëve përfshin:

- përzgjedhjen paraprake;
- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të eksperiencës e të trajnimeve, të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

- Përzgjedhja paraprake e kandidaturave do të realizohet nga Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Mbrojtjes, mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga kandidatët. Njësia e Burimeve Njerëzore verifikon dokumentacionin e aplikantëve, nëse ai është i plotë dhe i saktë, si dhe plotësimin e kërkesave të pozicionit të punës nga ana e tyre dhe përcakton kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit. Vetëm kandidatët që plotësojnë kërkesat e pozicionit do të njoftohen për vazhdimin e mëtejshëm të konkurimit.

Konkurimi me kandidatët që plotësonë kërkesat e pozicionit të punës përfshin:

- vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve (vlerësimin e arsimimit/kualifikimit, vlerësimin e trajnimit dhe vlerësimin e eksperiencës të lidhura me fushën përkatëse;
- intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i tyre do të bëhet nga komisioni përkatës.

Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 100 (njëqind), të cilat ndahen:

- a. 40 pikë, për vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve;
- b. 60 pikë, për intervistën e strukturuar me gojë.

Vlerësimi i dokumenteve të kandidatëve përfshin:

- a. vlerësimin ejetëshkrimit (CV);
- b. vlerësimin e kualifikimeve akademike, profesionale dhe teknike;
- c. vlerësimin e trajnimeve;
- d. vlerësimin e eksperiencave të ngjashme të punës;

Pikët totale të vlerësimit të dokumenteve ndahen, si më poshtë:

- a. jetëshkrimi, 5 pikë;
- b. arsimimi/kualifikimi, 15 pikë;
- c. trajnimi, 5 pikë;
- d. eksperiencia/përvoja në punë, 15 pikë.

Intervista zhvillohet me gojë me të gjithë kandidatët që janë përzgjedhur gjatë fazës së përzgjedhjes paraprake. Qëllimi i intervistës është të verifikojë aftësitë, motivacionin dhe aspiratat e çdo kandidati, si dhe përputhshmërinë e profilit profesional të kandidatit me pozicionin që do të mbulojë.

Intervista zhvillohet e strukturuar me qëllim që të sigurojë informacion të saktë rreth profilit profesional të kandidatëve. Ajo strukturohet në varësi të pozicionit që punonjësi do të mbulojë dhe eksperiencës.

Gjatë intervistës kandidatit i drejtohen disa pyetje nga anëtarët e komisionit, përgjigjet e të cilave vlerësohen me pikë. Çdo pyetje ka një sasi të caktuar pikësh, të cilat vlerësohen në varësi të përgjigjes. Në total intervista ka 60 pikë.

Kandidatët të cilët nuk marrin më shumë se **70 pikë**, (që përfshin vlerësimin e dokumenteve të kandidatëve, si dhe vlerësimin e intervistës së strukturuar), s'kualifikohen nga konkurimi.

Në mbyllje të procesit të vlerësimit, tre kandidatët që kanë marrë më shumë pikë i paraqiten autoriteteve vendimarrëse për miratimin e kandidatit më të përshtatshëm për mbulimin e pozicionit të shpallur vakant.

Me emërimin në pozicionin e punës do të lidhet kontrata individuale e punës.